

SHKRIMTARI NË MESIN E PENSIONISTËVE

POETI ISMAIL GANIU DHE LIBRI “FJALËT E MIA”

Libri i poetit veteran i arsimit Ismail Ganiu “Fjalët e mia” është libër i shtatë me radhë në krijimtarinë e tij. Poeti në këtë libër 140 faqesh ka shkruar 91 poezi të përshtatshme për të gjitha moshat

Veterani i arsimit, poeti Ismail Ganiu u lind në vitin 1947 në Likovë ku kreu shkollën fillore. Ka të kryer Shkollën Normale të Mësuesisë dhe Akademinë Pedagogjike - gjuhë dhe letërsi shqipe si dhe ka diplomuar në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Rreth 43 vite ka punuar si arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Për punën e tij të suksesshme në sferën e arsimit, është dekoruar me titullin “Arsimtar i dalluar”. Një kohë të gjatë ishte edhe kryetar i Shoqatës së Arsimtarëve të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Libri i poetit veteran i arsimit Ismail Ganiu “Fjalët e mia” është libër i shtatë me radhë në krijimtarinë e tij. Poeti në këtë libër 140 faqesh ka shkruar 91 poezi të përshtatshme për të gjitha mo-



shat, sidomos për të rinjtë dhe për të rriturit. Poezitë e përfshira ngërthejnë në vetë një mori temash të marra nga përditshmëria e jetës. Ndër të tjera shkruan: për fjalën, jetën, njeriun, Karadakun, dëshmorët, vendlindjen, mësuesin, alfabetin, kohën, nënën, babën, flamurin, veteranët, shkollën, mikun, traditën etj. Duke ditur rëndë-

sinë e fjalës në jetën e njeriut, ai jo rastësisht tre poezive të para në libër ia kushton fjalës. Në një strofë të poezisë “Fjalët e mia” titull të cilin mban edhe libri, shkruan: Fjalët e mija gjithnjë presin rend, ato ku të shkojnë zënë një vend, krijojnë shoqëri vetëm me modesti, kurrë në borxh nuk më kanë shti...

Poeti Ismail Ganiu shkruan edhe për rëndësinë e shfrytëzimit të kohës duke porositur se duhet shfrytëzuar atë sepse ikën shumë shpejtë. Këtë ai e shpreh shumë mirë në poezitë: “Po vjen koha” dhe “Vallë, a do të kam kohë”. Në një strofë të poezive të përmendura shkruan: “Se di a kam kohë, por kam dëshirë dhe shpresë, që t’i kryej ca obligime, para se të vdes”... Shumë bukur dhe në mënyrë prekëse përshkruan dashurinë e nënës me zemër bujare ndaj fëmijëve, dëshirat e saja për edukim të mirë të tyre. Në dy vargjet e dy strofave të fundit të kësaj poezie me titull “Nëna, sinonim i flijimit dhe shpresës” ai shkruan: Teknika prodhon çdo gjë në këtë botë, por nuk lind fëmijë dhe nëna që derdhen lot; si dhe në strofën tjetër: e madhe është nëna, me këngë dhe me vaj, kur të vdes ajo edhe dielli do të qajë... Si veteran i arsimit, në poezinë “Për veteranët e”..., autori ndër të tjera kërkon edhe rritjen e cilësisë në mësim

duke theksuar se ajo nuk është në nivelin e duhur. Në poezinë “Në këtë jetë”, poeti në mënyrë të mrekullueshme përshkruan jetën e njeriut në këtë kohë në të cilën ai kërkon që të ndalet zullumi, të ndikohen njeri me tjetrin, të mos punohet vetëm për interes.

Poeti Ismail Ganiu, shkruan edhe poezi kombëtare, për traditën, për gjuhën, kurbetin etj. Në poezinë “Duke prit babin”, në katër vargjet e para shkruan: Kur iku babi në kurbet, ne ishim fëmijë, nëna e përcolli, me lot në sy...

Poezitë në përmbledhjen e poetit Ismail Ganiu, kanë shpirt dhe ide ku zënë një vend të veçantë në zhvillimin e veçorive emocionale të personalitetit në pasurimin e botës shpirtërore në kalitetin e vullnetit, moralit, ta duam jetën dhe njeri tjetrin etj. Tematika e zgjedhur dhe rima e përshtatur, bëjnë që sapo të fillosh t’i lexosh, nuk ke të ndalur. Shihet se poeti në fjalë është mjeshër i përputhjes së vargjeve në rimë. Duke parë vlerën e poezive të zgjedhura në këtë përmbledhje të autorit të mirënjohur Ismail Ganiu, libri u mbështet financiarisht nga Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë sipas programit për vitin 2022 për nxitje dhe zhvillim të veprimtarisë botuese dhe krijimtarisë në moshën e tretë. (Baki Bakiu)

Punëtori për njohjen dhe mbrojtjen nga dezinformata



Në përditshmërinë tonë ndeshemi me informacione të rreme dhe dezinformata të panumërta nga lajmet tradicionale, e sidomos në rrjetet sociale, ku është gjithnjë e më e vështirë të marrim informacionin e duhur dhe kur përballemi me të, si të kuptojmë se është e vërtetë apo është dezinformate, gjegjësisht si t’i dallojmë. Lajmet e rreme zakonisht krijohen ose shtrëmbërohen me qëllim. Në hapësirat e Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, në organizim të Institutit për Komunikime Publike nga Shkupi, në kuadër të projektit “Përdor faktet”, financiar nga Qeveria e Britanisë së Madhe, me mbështetjen e Ambasadës britanike në Shkup u mbajt punëtori për njohjen dhe mbrojtjen nga dezinformata.

Kryetarja e LSHPM Stanka Trajkova i përshëndeti mysafirët në punëtori, e cila mes tjerash tha, “Kur nuk jam e sigurt nëse një lajm është dezinformim apo jo, konsultohem dhe më paralajmërojnë vazhdimi-

sht që të mos besoj gjithçka që lexoj në Facebook. Ne aplikojmë njohuritë se si të mbrohemi nga dezinformatat në gazetën e pensioneve, e cila nuk përmban dezinformata, por vetëm fakte”. Në emër të Institutit për Komunikime Publike foli Leila Shaban, menaxhere e projektit në Institut, e cila theksoi se ideja e seminarit është të njohim informacionin dhe si të mbrohemi prej tij. Në seancën e parë, ligjëruese ishte Jasmina Mironski, gazetare, e cila foli për informacione të rreme dhe manipulime mediatike në kohën që jetojmë. Ligjëruesit e punëtorisë dhanë disa këshilla si gjithmonë të kihet një qasje kritike ndaj çdo informacioni, të kontrollohen burimet e shumta, të merret informacion nga media të besueshme, të mos lexohen vetëm tituj. Këto janë vetëm disa nga këshillat që ligjëruesit tanë Jasmina Mironski dhe Sonja Petrushevska Popovska i dhanë, duke treguar se ku dhe si të raportojnë dezinformatat. (Vasil Paçemski)

SHP SARAJ

Janë realizuar detyrat programore

Lidhur me pikën e parë, kryesuesi i dha fjalën Mahir Durakut, i cili ndër të tjera ka folur për bashkëpunimin me Komunën, me LSHPM, me shoqatat, me Kompaninë “Dauti Komerc” e cila gjithnjë na ndihmon

Më 14 mars të këtij viti, Kuvendi i SHP Saraj, ka mbajtur seancën e parë të saj në përbërje të re e cila është mbajtur në sallën e Komunës Saraj. Në këtë seancë, pos anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe anëtarë të KE, të KM, kryetarët e degëve si dhe përfaqësues nga: Komuna Saraj, SHPIP, SHP GjoçePetrov, SHP Tetovë, SHP Gostivar, përfaqësues nga Kryqi i kuq, përfaqësuesi nga Fondacioni “Albiz” dhe “Dauti Komerc” etj. Me seancën ka drejtuar kryesuesi Enver Aliu, i cili ka përshëndetur të pranishmit dhe pas miratimit të procesverbalit të seancës së kaluar, ka propozuar rendin e ditës i cili është miratuar pa ndryshime dhe plotësime. Si pika të rendit të ditës, më të rëndësishme ishin Raporti për punën e organeve dhe trupave të shoqatës për vitin 2022, Raporti financiar për të hyrat dhe të dalat me Raport nga Këshilli mbikëqyrës. Lidhur me



pikën e parë, kryesuesi i dha fjalën Mahir Durakut, i cili ndër të tjera ka folur për bashkëpunimin me Komunën, me LSHPM, me shoqatat, me Kompaninë “Dauti Komerc” e cila gjithnjë na ndihmon.

Përfaqësuesi i Komunës Saraj, sekretari Xhelal Jakupi, ka përshëndetur të pranishmit duke ju dëshiruar shëndet dhe suksese në aktivitete. Komuna Saraj, në mundësitë e veta do të vazhdoj edhe në të ardhmen t’ju del në ndihmë kësaj kategorie. Baki Bakiu, anëtar i KE dhe i Kuvendit, shkurt ka folur për ndryshimet në statut dhe zgjedhjet në Shoqatë, për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Kryqin e kuq (aktivitetet e përbashkëta në Klub – Qendrën ditore për persona pleq dhe ndihmë në kushte shtëpiake), për Mirënjohjen e marrë nga LSHPM për kontributin e dhënë të Shoqatës me rastin e shpalljes “Viti i pensionistit rural 2022”, më pastaj

për praninë e aktiviteteve të Shoqatës në gazetën “Penzioner plus “dhe KOHA”.

Aktivitetet e Shoqatës në vitin 2022 i kanë përshëndetur edhe mysafirët e pranishëm:

Nijazi Xhelili nga SHP Gostivar, i cili ka folur më gjerësisht, Selver Memedinga SHP Tetovë, Mitko Stojanoski nga SHP Gj. Petrov dhe Lutfi Kabashi nga SHPIP Saraj.

Në fund, Raporti për punën e Shoqatës në vitin 2022 është aprovuar. Edhe lidhur me pikën Raport financiar për të hyrat dhe të dalat në Shoqatë në vitin 2022, arsyetim ka dhënë Mahir Duraku, ndërkaq pas dhënies së raportit edhe nga Këshilli mbikëqyrës – kryetari Hamit Bakiu, Raporti është miratuar. Në fund është përfunduar se aktivitetet programore në Shoqatë dhe të dhënat financiare realizohen në pajtim me aktet e Shoqatës dhe të LSHPM ku jemi anëtarë. (Baki Bakiu)